



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 106 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 5 të Rregullës Zgjedhore Nr.06/2013 Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 21.10.2021, nxjerr këtë:

## VENDIM

### Për Miratimin e Rekomandimit të V të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve për Përfshirje në Rezultate, për Zgjedhjet Lokale 2021

- I. Miratohet rekomandimi i pestë i Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, për përfshirje në rezultate, për zgjedhjet lokale 2021.
- II. Obligohet Sekretariati për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti detaj dhe i specifikuar sipas vendvotimeve.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Duke u bazuar në rekomandimin e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR) të datës 21.10.2021, gjatë procedimit të materialit zgjedhor nga vendvotimet e specifikuar si pjesë përbërëse e këtij vendimi, QNR-ja, rekomandoj që të gjitha vendvotimet si në listë të bashkangjitur këtij vendimi, fletëvotimet për Kryetar Komune dhe të cilat janë gjendur në kutinë për Kuvendin Komunal, dhe pas hetimeve dhe konfirmimit nga Komisioni Komunal Zgjedhjeve-KKZ dhe Kryesuesit e Vendvotimit si dhe pas verifikimeve rezulton se ai fletëvotim është i rregullt, i vlefshëm dhe i takon atij vendvotimi, të përfshihet në rezultatet përfundimtare të atij vendvotimi.

Andaj, KQZ-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 21.10.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Qendra e Numërimit dhe Rezultatëve

Raporti i hetimit të rastëve që janë dërguar në karantinë gjatë Pranimit të matërialit të ndjeshëm në QNR - Zgjedhjet Lokale 2021, 17.10.2021

Prishtinë, më 20.10.2021

Nr.	iD e Komu	Komuna	Vendvotimi	Përshkrimi i Rastit	Data e hetimit	Katëgoria	Lloji i zgjedhjeve	Veprimet e ndërmarra nga Ekipi Hetues	Të gjeturat nga Ekipi Hetues	Rekomandim	Të procesohet e rregullt
49	07	KAÇANIK/KAÇANIK	0703D/03D	Ne LV është gjetur nje fletvotim	19.10.2021	Fletëvotim	Kryetar Komune	KVV kanë shenuar në Librin e Votimit se fletëvotimi është hedhur gabimisht në kutinë për Kuvend Komunal	Fletëvotimi i takon atij vendvotimi dhe nuk është përfshirë në rezultate	Rekomandimi 5	Të përfshihet në rezultate pasi që fletëvotimi është i rregullt dhe i vulosur
111	19	PRISHTINË/PRIŠTINA/PRIŠTINE	1910E/07D	1 fletë votim per kryetar ne zarfin e KKZ	20.10.2021	Fletëvotim	Kryetar Komune	Është hetuar se fletëvotimi i takon atij vendvotimi	Fletëvotimi i takon atij vendvotimi dhe nuk është përfshirë në rezultate	Rekomandimi 5	Të përfshihet në rezultate pasi që fletëvotimi është i rregullt dhe i vulosur
127	25	FERIZAJ/UROŠEVAC	25124/02R	1 fletë votim per kryetar ne zarfin e KKZ	20.10.2021	Fletëvotim	Kryetar Komune	Është hapur kutia për Kryetar Komune	Fletëvotimi i takon atij vendvotimi dhe nuk është përfshirë në rezultate	Rekomandimi 5	Të përfshihet në rezultate pasi që fletëvotimi është i rregullt dhe i vulosur
181	25	FERIZAJ/UROŠEVAC	2502D/03R	1 fletë votim per kryetar ne zarfin e KKZ	20.10.2021	Fletëvotim	Kryetar Komune	Kryetar Komune	Fletëvotimi i takon atij vendvotimi dhe nuk është përfshirë në rezultate	Rekomandimi 5	Të përfshihet në rezultate pasi që fletëvotimi është i rregullt dhe i vulosur